



**VENDIM**

*Nr. 106, Datë 29.06.2016*

**PËR  
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË “RREGULLAT E  
TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16; 81 pika 2;99 dhe 110 pika 2 të Ligjit nr. 43/2015, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM Nr 244, Date 30.03.2016 “Per miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr 96 date 17.06.2016 te Bordit te ERE, dhe vendimit nr.102, datë 23.06.2016, të Bordit të ERE “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të energjisë elektrike” miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, Nr. 68, datë 23.06.2008, i ndryshuar,

**Vendosi:**

1. Miratimin e një ndryshimi në “Rregullat e Tregut miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s Nr. 68, Date 23.06.2008, i ndryshuar, si me poshte:

Në kapitullin IX. 1.3 gërma “g”, bëhet si më poshtë :

g.1“Duke filluar nga 1 Korriku 2016, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike, me perjashtim te subjekteve te percaktuar ne Ligjin nr.138/2013 “Per burimet e rinovueshme dhe sipas pikes 4 te nenit 99 te ligjit nr.43/2015 “Per sektorin e energjise elektrike.”

g.2Klientet fundorë qe furnizohen nga Furnizuesi i Sherbimit Universal nuk jane pergjegjes per disbalancat kundrejt ketij te fundit.

2. KESH sh.a duke qënë sigurues i shërbimeve ndihmëse dhe balancimit, nuk do të jetë subjekt i disbalancave për periudhën e mbetur të vitit 2016.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.